



REPUBLIKË KOSOVË 6.2022

KOMUNA LIPJAN

REPUBLIKA KOSOVO

OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më:	02.06.22	
Primljenë:		
Njësia / Jednica	Vatimi Broj	Shtojca Dodatak
1-312102-25419		



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

E lidhur në Prishtinë, me datë: 01 Qershor 2022, ndërmjet:

- (1) Kompania Kosovare për Distribuuam me Energji Elektrike Sh.a., një kompani e inkorporuar në mënyrë të rregullt sipas ligjeve të Kosovës, me nr. të regjistrimit të biznesit 810799364, selia e së cilës gjendet në Boulevard Bill Clinton. Nr.5, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës (në tekstin vijues "KEDS"), në njëren anë, dhe
- (2) Komuna e Lipjani, me adresë në, Lipjan, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti (në tekstin vijues "Komuna") në anën tjetër.

(ndaras "Pala" dhe së bashku "Palët")

PËRDERISA:

- (A) Komuna e Lipjanit ka kërkuar furnizimin e Parkut të Biznesit (Qylag) me Energji Elektrike.
- (B) KEDS-i merr përsipër ndërtimin e linjës 10 (20) kV rrëth 1.5 km, lirimin e Komunës se Lipjanit nga pagesa e pëlqimit energetik (për fuqinë e angazhuar) si dhe përgatitjen e projektit për ndërtimin e TS 10 (20) /0.4 kV dhe projektin për shpërndarjen e pjesës TU brenda parkut të biznesit.

Neni 1 Qëllimi i Memorandumit dhe Pagesa

- 1.1. Komuna e Lipjanit në bashkë me KEDS-in, do të përgatisin infrastrukturën për furnizim me energji elektrike të zonës industriale në vendin (lokacioni-Qylag) si në vijim.

Neni 2.

Obligimet e KEDS Sh A

2.1. KEDS-i merr përsipër ndërtimin e linjës ajrore 10 (20) kV rreth 1.5 km (mirëpo në çoftë se ekziston infrastruktura nëntokësore do te thotë kanali me gypa dhe puseta ashtu se si është deklaruar Komuna e Lipjanit qe ekziston kjo infrastrukturë, atëherë KEDS do të shfrytëzoj këtë infrastrukturë nëntokësore dhe do të realizoj shtrirjen e kabllit nëntokësor 10(20) kV). Gjithashtu KEDS do të bëjë lirimin e Komunës se Lipjanit nga pagesa e pëlqimit energetik (për fuqinë e angazhuar) si dhe përgatitjen e projektit për ndërtimin e TS 10 (20) /0.4 kV dhe projektin e shpërndarjes se pjesës TU brenda parkut te biznesit.

2.2. Përshpejtimin e pranimit teknik dhe kyçjen e parkut në rrjet.

Neni 3

Obligimet e Komunës

3.1. Do të veproj ne harmoni me zgjidhjen teknike (projektin) të dhënë nga KEDS Sh.A duke i kryer të gjitha punët për vendosjen e TS 10 (20) /0.4 kV dhe shpërndarjen e pjesës TU sipas normave teknike me të gjitha elementet e nevojshme.

3.2. Do të ndihmoj ne zgjidhjen e çështjeve pronësore juridike për KEDS_in gjatë ndërtimit të linjës 10(20) kV.

Neni 4

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Palët do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Nëse mosmarrëveshjet nuk zgjidhen në mënyrë paqësore, kontesti do të i referohet gjykatës kompetente, në bazë të ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi nga data e nënshkrimit prej të dy Palëve, dhe do të mbetet në fuqi deri sa të ndryshohet me Amendament ose të ndërpritet me marrëveshje nga Palët.

Neni 6

Kohëzgjatja e këtij Memorandumi

- 6.1.** Projekti do të realizohet brenda afatit prej _____ muaj pas nënshkrimit te tij.
- 6.2.** Ky Memorandum bashkëpunimi mund të Amendamentohet në marrëveshje mes Palëve me pëlqimin e ndërsjellët të Palëve.
- 6.3.** Ky Memorandum është përgatitur në gjuhen shqipe dhe angleze në katër (4) origjinale, dy origjinale për Komunën e Lipjanit dhe dy origjinale për KEDS-in.

NË DËSHMINË E TË CILËVE Ky Memorandum realizohet në datën e vendosur në fillim të saj.

Për dhe në emër të Komunës së Lipjanit:

Emri: Imri Ahmeti

Pozita: Kryetar i Komunës së Lipjanit

Nënshkrimi:

Datë: 01/06/ 2022



Për dhe në emër të KEDS-it:

Emri: Alpin Dogan

Pozita: Drejtori Menaxhues i
KEDS

Nënshkrimi:

Datë: 01/06/ 2022

